



REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK  
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02-05/22                                       |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATE/A                | 29.04.2022                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

**PROCESVERBAL:**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së pestë (5) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 29.04.2022, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. **Shpejtim Gacaferi**: i cili në fillim përshëndeti nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zevendës Komandantin e stacionit të Policisë në Junik z. Xhafer Lokaj, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit.

**Anëtarët prezent:**

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK
5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Eliza Pepshi- Anëtare, LVV
14. Xhemë Tofaj-Anëtar,LVV

-Mungon: Lulzim Gacaferi-Anëtar,LVV

### Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raporti i buxhetit komunal për periudhën Janar –Mars 2022,
3. Informatë mbi gjendjen e shërbimeve publike në Komunën e Junikut;
4. Nxjerrja e vendimit për plotësimin -ndryshimin e projektrregullores për tatimin në pronën e Paluajtshme ;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës i Komitetit për Komunitete;
6. Të ndryshme;

### **Pika e parë e rendit të ditës**

#### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Sa i përket pikës së parë të rendit të ditës, materialet i keni përpara a ka dikush sa i përket procesverbalit që ka diskutuar, dhe nuk i është shënuar diskutimi? E hedhi në votim.

**z. Leonard Ljolluni:** Falemderit Kryesues përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket procesverbalit të pika e pestë iniciativën për marrëveshjen nderkomunale të paragrafi i fundit e pata shtruar edhe një pyetje për kryetarin e Komunës se të cili nen është thirrur Kryetari për vendimin të cilin e ka sjellë? ndërsa nuk është cekë kjo pyetje edhe të pika e ndryshme e kam shtruar një pyetje në lidhje me tenderin furnizim me barna edhe ajo pyetje nuk është cekë fare.

**z. Zenel Maloku:** Edhe une kom veretje të procesverbalit nuk po hy faqe për faqe por e kom lexuar ne shume vena ka shumë gabime besa edhe fjalët nuk jan shkru hiq mirë okon pa i mar senet personale po njeri qe e man procesverbalin gjona ta mban mirë mos të ketë nevojë të ketë ankesa tanaheret, unë kam thënë për rrugën që është ka bëhet te laura e Jasiqit kam thënë me i thirrur qytetarët me biseduar me ta, e me e leshuar rrugën po dua te them per më qenë rruga në rregull per mos të rrezikohen qytetarët që të bëhet rruga perpjedëz e madhe. Aty rrezikohen qytetarët e aty ne procesverbal e ka shenuar me i thirrur qytetarët se po rrezikohen qytetarët, nuk rrezikohen kur bohet rruga mirë, por kur bohet rruga keqe rrezikohen qytetarët. Unë po them me pas kujdes me procesverbal, me e bërë mirë qe kaq pata.

**Shpejtim Gacaferi:** E hedhi në votim procesverbalin me këto ndryshime.

**Nga 14 prezent, për ishin 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.**

## **Pika e dytë e rendit të ditës**

### **2. Raporti i buxhetit komunal për periudhën Janar –Mars 2022,**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Fjalën e kaloj të nenkryetari i Komunës së Junikut z. Besart Tofaj.

**z. Besart Tofaj:** Nënkryetari fillimisht përshëndeti anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit, fjalën e kaloj te drejtoresha për Buxhet dhe Financa .

**znj. Vjollca Qestaj:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa i njoftoj të pranishmit rreth shpenzimeve të raportit të buxhetit Komunal për periudhën Janar - Mars 2022.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Fjalën e kaloj të Leonard Lllolluni .

**z. Leonard Lllolluni :** Unë e kam nje pyetje ndoshta jo vetem per drejtoreshen por për te gjitha drejtoritë, në faqen 9 tek raportin detaj i shpenzimeve sipas drejtorive.

Fillojmë me zyrën e kryetarit tek sherbimet tjera kontraktuese 191.49 euro ,nuk po e di se per çfarë po behet fjalë edhe tek reklamat dhe konkurset 480 euro ,nuk po e di për cilat reklama dhe konkurse.

Tek administrata kemi sherbime tjera kontraktuese 20,639.80 nuk e kam të qartë dhe po kërkojmë shpjegim se për çfare bëhet fjalë . Sërish tek administrata 480 euro, sikur ne zyrën e kryetarit e njëjta shumë për reklama dhe konkurse prap këtu nuk po e di se per çfar bëhet fjalë dhe kërkoj shpjegim.Drejtoria e zhvillimit ekonomik per shërbime tjera kontraktuese 4197.94 , kërkoj shpjegim.Drejtoria e shërbimeve publike 20,086.00 sqarim shtesë.

Pastaj e kemi Kuvendin Komunal per sherbime te telefonise 62.09 dua te di sa telefona i ka kuvendi edhe ushqim dhe pije 70 euro, gjithashtu edhe dreka zyrtare 148.00 ku ne si kuvend e di se nuk kemi bere ndonjë organizim ose drekë . Me intereson ta di se për çfarë janë shpenzuar keto para? Përsëri e njëjta pyetje për drejtorinë për buxhet dhe financa për shumën 512.44 . Nuk e kam të qartë edhe për arsimin fillor 15,946.72 për sherbime tjera kontraktuese edhe tek arsimi mesëm 2827.20 prap shërbime tjera kontraktuese. Kalojmë tek QKMF 7230.00 shërbime tjera kontraktuese gjithashtu ne QKMF: avans për para te imëta 150 euro ne nuk e dijmë a janë shpenzuar apo çfarë është bërë me to. Për të gjitha keto paçartesi kërkojmë sqarime.

Për sqarimet e kërkuara nga zt.Leonard Lllolluni pergjigjen e jep zt. Arten Hamza për të gjitha shpenzimet e cekura më lartë.

**z. Leonard Lllolluni ;** kërkon sqarim nga drejtoritë përkatëse për secilin shpenzim.

**z. Shpejtim Gacaferi :** Leonard ,mjafton qe pergjigjen po e mer dhe nuk ka aspak rëndësi se kush u pergjigj në sqarime.

**z. Arten Hamza:** Raporti i shpenzimeve është i përgatitur dhe i nënshkruar nga ZKF (nga unë) dhe unë mbaj pergjegjësi për të gjitha të dhënat dhe shenimet ne këtë raport .

**z. Shpejtim Gacaferi :** Ndërsa për shpenzimet e Kuvendit ku u cek se sa telefona i ka kuvendi ,ne e kemi vetëm një telefon (telefoni im), telefon fiks nuk kemi, dhe as qe na duhet. Por sa kam unë informacion ne e kemi trashëguar një kontratë per disa aparate telefonike dhe ne paguajmë për çdo muaj, ku edhe ne muajin e parë unë e kam kundërshtuar drejtoreshen dhe nuk kam dashur ta nënshkruaj. Edhe pse unë e kam numrin tim shumë pak e shfrytezoj edhe vet e keni vërejtur se unë shumicen e herave, ju therras me numër timin privat. Për të mos u keqkuptuar aparatet janë mare më heret ne i kemi vetem numrat. Pra edhe sikur ne mos ti mernim fare numrat ne kemi obligim per të berë pagesat, sepse kontata akoma eshte valide. Për shpenzimet me ushqim dhe pije 70 euro janë berë në ditën e inaugurimit të Kuvendit Komunal. Ndërsa për dreken zyrtare Ju nuk keni qenë po unë dhe zt. Zenel Maloku po kemi qene ne kete drekë qe e kemi pase kerkesë prej ish brigades 138 per lejinim ne shfrytezim te salles se kuvendit ku kane berë shperndarjen e flamujve per heronjtë që kanë renë në “Betejen e Koshares” ,te komunes se Junikut dhe Deçanit. Dhe po këtë ditë qe e kemi leju shfrytezimin e salles i kemi ftuar ne drekë modeste ,ishim diku rreth 50 vetë dhe po shihet qe per 50 persona eshte bere shpenzim 148 euro.

**z. Leonard Lllolluni :** Kërkoj sqarim për shpenzimet e tjera kontraktuese në QKMF .

**z. Fatos Shala :** Menjëherë si ja kam filluar punës si Drejtor ne këtë dikaster më ka ardhur një faturë për të berë pagesën për “CARITAS” , si borgj i mbetur i vitit paraprak.

### **Pika e tretë e redit ditës**

#### **3. Informatë mbi gjendjen e shërbimeve publike në Komunën e Junikut**

**z. Shpejtim Gacaferi:** sa i përket kësaj pike unë kam kërkuar informatë bazuar ne planin e punës të Kuvendit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, raportin me shkrim e kemi pranuar nga Drejtori i Sherbimeve Publike, Drejtorin nuk e kemi por informatën e keni pranuar.

**z. Leonard Lllolluni:** Unë e kam një pyetje meqenëse drejtori mungon pasqyrat finaciare qe i solli drejtoria për buxhet dhe financa, nuk figurojnë askund shpenzimet lidhur me punimet të cilat janë përfunduar nuk janë të prezantuar ato shpenzime.

**z. Arten Hamza:** Në raportin të cilin e ka prezantuar Drejtoria e Sherbimeve publike ne KPF, nuk janë prezantuar sespe aktiviteti ka filluar por punimet vazhdojnë kur te përfundojnë punimet behet pranimi teknik dhe sjellët fatura nga aperiatori ekonomik, atëherë prezantohet si shpenzime.

**z. Besart Tofaj:** Deshta të ndërlidhem te raporti i Drejtorisë për Shërbime Publike, sa i përket kërkesat të cilat janë berë nga Dervishi dhe Rajmonda, aktivitetet janë duke u zhvilluar pasi të përfundojnë të gjitha punimet ne do ta sjellim raportin e shpenzimeve.

**z. Dervish Bajraktari:** Meqenëse i permendet kërkesat të cilat i kam parashtruar, e raportin e prezantuar e kam lexuar por kërkesat e mija nuk janë prezantuar askund në këtë raport edhe fillimi i punimeve nuk ka filluar askund lidhur me kërkesat e mija.

**z. Zenel Maloku:** Unë deshta të flas për kërkesat e mija që i kom propozuar në mbledhjen e kaluar për vendosjen e shenjave ku ka mungesa, mire ish kon me pas qellu Drejtori i Shërbimeve Publike me na dhënë sqarime po na kushton shumë nuk osht ne rregull tëshfrytëzohet trotuari për kerre, edhe policia e parkon ne trotuare kerrin e vet pa drita, ndërsa qytetari kur e parkon kerrin ne trotuar policia e dënon menjëherë, unë jam duke e persiretur me mija herë këtë problem, por nëse nuk ndërmerri hapa unë do ta lajmroj prokurorinë, nxënësi shkon asfaltit ne shkollë e trotuari grumbull me kerre, nesër me të ndodhë fatkeqësia me ta shkel ndonjë fëmi kerri, kryetari drejtori i arsimit zeneli i shkon ne vorrim erdhëm meju ngushelluar, nuk është në rregull kjo punë.

**z. Besart Tofaj:** Unë i mbeta borxh Dervishit lidhur me kërkesat e paraqitura, punimet janë duke u zhvilluar në “lagjen qendër” dhe në “lagjen Krasniq” shumë shpejt do të fillojnë edhe në “lagjen Berishë”, gjithashtu kërkesën që e ka paraqitur Zeneli për heqjen e tabelës afër postes edhe ajo është larguar, gjithashtu shenjëzimi ka filluar në rrugën kryesore Junik-Rastavicë është duke punuar me një intezitet të lartë edhe për punimet e tjera që janë duke u zhvilluar dhe me një mbikqyerje reale, gjithashtu në rrugën kryesore prej Komunës deri të shkolla fillore qeverija e kaluar nuk e ka pa të udhës ndërtimin e trotuarit për kembesoret por ne e kemi menduar dhe shumë shpejt do të ndërtohet tretuari për këtë pjesë, kemi diskutuar edhe me policinë në Junik lidhur me sigurinë prej mëngjesi deri ne orën 12:00 të këtë kujdes dhe mbikqyerje më të madhe sespe frekuentimi është më i madh.

**z. Leonard Lllolluni:** Nese unë e vendosi veturën time afër kafiterisë në “Shekull” apo në “Bar Friends” policia menjëherë reagon, e nëse vendoset vetura përpara objektit të komunës nuk të reagon askush?!

**z. Sadri Krasniqi:** Deshta të lidhem me këtë temë, unë dhe Zeneli nuk veprojmë të parët drejtë sespe nuk e parkojmë veturën aty ku duhet, unë kërkojë që të behet zgjidhja e menjëhershme nuk mundem ta hedhim fajin edhe te policija ne duhet secili të mendojmë për zgjidhjen e me te mirës për kete problem.

**z. Leonard Lllolluni:** Kryesues kërkojë nga ju meqenëse e kemi rregulloren e punës së Kuvendit, mos ta merr fjalën dikush pa leje që nuk është i autorizuar të flas në Kuvend, kur e adreson kryetari është gjithqka në rregull.

**z. Zenel Maloku:** Unë të falënderoj ty kryesues ndoshta e teproj me diskutimet e shpeshta që e marr fjalën, por ju nuk jeni si ish kryesuesi i kaluar që e perfundojke fjalën me një minut por jeni shumë tolerant, por e kom një replikë për Sadrinë që është tuj e përkrah punën e qoreditur unë nuk kom pa shaj aty, edhe nund parkoj edhe shejen me lepak, une nuk e kqyri cili pushtet e ka bo por punën e mirë duhet mi përkrah nga te gjithë, e punën e qoreditur kerkush.

#### **Pika e katërt e rendit të ditës**

**4. Shqyrtimi dhe shfuqizimi i vendimit numër 02/04/04 i datës 26.02.2021, për subvencionimin e qytetarëve të Komunës së Junikut të cilët kanë rezultuar me Covid- 2**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Kërkesa për shfuqizim ka ardhur nga Drejtori i Shëndetësisë dhe nga Drejtori i QKMF-së që të shfuqizohet ky vendim.

#### **Pika e pestë e rendit të ditës**

**5. Nnxjerrja e vendimit për plotësimin -ndryshimin e projektregullores për tatimin në pronën e Palujtshme.**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Sa i përket kësaj pike, fjalën e kaloj të Drejtoresha për Buxhet dhe Financa.

**z. Vjollca Qestaj:** Ne baze të ligjit për Tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005 dhe udhëzimit nr.03/2018 për metodologjinë e vlerësimit të pronës së paluatshme, komunat shqyrtojnë dhe përcjellin vlerën e tregut për pronat e tyre çdo 3 vite deri në 5 vjet, andaj ne si drejtori e financave kemi kërkuar që kjo rregullore të shqyrtohet edhe këtë vit dhe këto norma të miratohen për vitin 2023, pasi që komunat e bëjnë miratimin e normave paralelisht me miratimin e buxhetit në kuvendin komunal.

#### **Pika e gjashtë e rendit të ditës**

**6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës i Komitetit për Komunitete.**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Materialin e keni marrur me kohë besoj që keni pasur kohë për ta vlerësuar. Andaj e hedhi në votim.

**Nga 14 prezent, për ish-in 14, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.**

## Pika e shtatë e rendit të ditës

### 7. Të ndryshme .

**z. Shpejtim Gacaferi:** Sa i përket kësaj pike, nëse keni diçka?

**z. Leonard Lllolluni:** Kam një pyetje për Drejtorin e Arsimit përse është anuluar konkursi për sekretar në shkollën fillore Edmond Hoxha?

**z. Xhavit Velijaj:** Konkursi është anuluar sespe nuk është publikuar në gjuhët zyrtare.

**Z. Leonard Lllolluni:** Konkursi është anuluar drejtor, sepse kanë konkurruar militantët e partisë së juaj, kërkoj nga procesmbajtësi ta shënon si dëshmi këtu do të punësohet sekretar shkolle ose Zeqë Shehu ose Redona Gaxherri, dhe nuk do ti jepet mundësia Sindije Idrizit. Gjithashtu tenderin furnizime me barna për QKMF, kemi informata se tenderi për furnizim me barna do ta fiton shoku i Visar Shehut, sepse kemi dëshmitë e bisedës në telefon në mes të Visarit dhe shokut tij e që ne do ti dërgojmë në prokurori.


**z. Zenel Maloku:** Unë deshta të ndërlihem për dëmet të cilat ju kanë shkaktuar pronarit Xhemë Gjocaj nga operatori ekonomik lidhur me vërshimet që kanë ndodhur në bllokimin e rrugës, ku operatori ekonomik në mënyrë jo të rregullt të gjithë dheun e ka hedhur në livadhin e personit në fjalë, shumë keq që nuk është këtu Drejtori i Sherbimeve publike, unë i kom thonë se dëmet të cilat ja keni shkaktuar duhet me i riparuar, Drejtori në fjalë mu ka drejtuar më ka thonë merre kolicen dhe shko me ndihmuar mi largu dheun prej livadhit nuk është kjo fjalë e mirë, është fjalë shumë e qoroditur me bo hajgare me pronarin.

**z. Shpejtim Gacaferi:** E shpalli të mbyllur mbledhjen e pestë të Kuvendit Komunal në Junik, ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:00.

Procesmbajtësi:

z. Arton Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

